

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR
MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARIVE TË SHFRYTËZIMIT NË FONDIN PYJOR
KOMBËTAR NGA INDIVIDË APO SUBJEKTE TË LICENSUARA”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është që të përcaktojë procedurat që ndiqen nga individët apo subjektet e licensuara, gjatë kryerjes së veprimtarive të shfrytëzimit në fondin pyjor kombëtar.

Objektivi që synohet të arrihet, është rregullimi ligjor i veprimtarive të shfrytëzimit në fondin pyjor, duke shmangur keq-përdorimin dhe duke marrë në konsideratë se pyjet janë një burim ekonomik që sjellin zhvillim, punësim, për të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë (bujqësi, industri, energji, turizëm, argëtim, etj.), ndaj përdorimi dhe përfitimi i të mirave duhet të jetë: (i) i qëndrueshëm në raport me mundësinë; (ii) i optimizuar sipas vlerës së përdorimit; (iii) i shpërndarë në mënyrë të drejtë në raport me investimin, punën dhe riskun e marrë përsipër; (iv) duke patur si prioritet, shtresat e popullsisë në nevojë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME
PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË
TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve, për vitin 2023, dhe del në zbatim të pikës 3, të nenit 23, të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Projektvendimi gjen mbështetje dhe është në një linjë me përcaktimet/drejtimitet e dhëna nga dokumente të tjera për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, si SKZHI-ja 2020, dokument kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, si dhe VKM nr.814, datë 31.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030”.

- a. Gjithashtu, projektvendimi është hartuar në përputhje me parashikimet e dokumenteve sektoriale që ndërthuren me pyjet.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Pyjet si pasuri kombëtare, kanë peshë dhe rëndësi të veçantë në zhvillimin dhe progresin e vendit, ndaj duhen pozicionuar në një linjë me politikat dhe objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar, me kontribut të qenësishëm, duke zhvilluar sektorin nëpërmjet një sistemi të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, strategjive, programeve, dhe planeve të mbarështimit, duke integruar dhe optimizuar interesat midis përdoruesve dhe mundësive të përdorimit/shfrytëzimit të fondit pyjor.

Propozimi i këtij vendimi synon të rregullojë ligjërisht veprimtaritë shfrytëzuese që ushtrohen mbi fondin pyjor, të kategorizuara sipas tipit të punimit. Procedurat që ndiqen për secilin punim konturojnë të gjithë procesin në tërësi dhe shmangin hapësirat për abuzime si në afate, por në të njëjtën kohë dhe në procedura. Gjithashtu, miratimi i këtij vendimi del si domosdoshmëri për të ruajtur ekuilibrat natyror veçanërisht për ato lloje punimesh që lidhen me shfrytëzimin e prodhimeve jodrusore dhe të bimëve medicinale e etero vajore nga pylli.

Miratimi i këtij projektvendimi, rregullon dhe garanton gjithashtu gjurmimin e produkteve që dalin nga fondi pyjor kombëtar dhe mundëson pajisjen e tyre me certifikatën e origjinës.

Për sa më sipër, vendimi i propozuar do të sjellë një administrim më të mirë të sektorit dhe fondit pyjor kombëtar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për Pyjet” dhe vjen si propozim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe është në harmonizim me kuadrin ligjor në fuqi për pyjet.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti i propozuar nuk synon të përafrojë asnjë dokument të *acquis e BE-së*, pasi është akt që bazohet në legjislacionin e brendshëm të vendit.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese e PëRMBAJTJES Së PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet këtij projektakti, parashikohet rregullimi ligjor i procedurave që ndiqen gjatë kryerjes së veprimtarive shfrytëzuese në fondin pyjor kombëtar e bazuar kjo në tipin e punimit. Veprimtaritë në fondin pyjor janë kategorizuar në 5 si të tilla konkretisht:

- Punimet për shfrytëzimin e lëndës drusore dhe të asortimenteve;
- Punimet dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore;
- Punimet për prerjet kulturale;
- Punimet për mbrojtjen e tokës pyjore.
- Vjelja dhe grumbullimi i bimëve mjekësore, etetovajore e tanifere natyrore (BMET) dhe prodhimeve pyjore jodrusore;

Në funksion të qartësisë si dhe të zbatimit të këtij projektvendimi, për të gjitha punimet që lidhen me veprimtaritë shfrytëzuese në fondin pyjor kombëtar, janë dhënë përkufizimet përkatëse referuar në literaturën teknike.

Projektvendimi është strukturuar në 2 krerë. Në Kreun e parë të projektvendimit jepen dispozitat e përgjithshme të tij, ku në nenin e parë përcaktohet qëllimi i këtij projektvendimi dhe në nenin e dytë jepen përkufizimet për termat e përdorur.

Kreu i dytë i këtij projektvendimi është strukturuar në 5 nene dhe përcakton procedurat për kryerjen e secilës nga veprimtaritë e shfrytëzimit në fondin pyjor. Në secilin nen në vijim, janë parashikuar procedurat për secilën kategori të punimeve që përfshihet në veprimtaritë e shfrytëzimit.

Neni 3 parashikon rregulla mbi procedurën për shfrytëzimin e lëndës drusore dhe asortimenteve në fondin pyjor kombëtar, i cili përbëhet nga 6 pika dhe nga 5 gërma.

Në nenin 4, është parashikuar procedura e kryerjes së punimeve dhe aktivitetet në infrastrukturën pyjore. Procedurat janë strukturuar në 5 pika ku, në pikën e parë të këtij neni janë përjashtuar nga procedurat individët. Të gjithë pikat e tjera rregullojnë procedurat për subjektet e licensuara që do të kryejnë këtë veprimtari në fondin pyjor.

Neni 5 parashikon procedurën për kryerjen e punimeve për prerjet kulturele. Edhe në këtë tip punimi, individët janë përjashtuar dhe procedura është parashikuar vetëm për subjektet e licensuara që dalin fituese nga procedurat e konkurimit publik.

Në nenin 6 është parashikuar procedura për kryerjen e punimeve për mbrojtjen e tokës pyjore, në të cilën kategorizohen punimet e pyllëzimit të sipërfaqeve pyjore dhe ato për sistemimet malore.

Në nenin 7 është parashikuar procedura për vjeljen dhe grumbullimin e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore dhe prodhimeve pyjore jodrusore.

Rregullimi i procedurave të shfrytëzimit të fondit pyjor kombëtar do të garantojë kontrollin e veprimtarive të shfrytëzimit që kryhen mbi fondin pyjor dhe mundëson gjurmimin e produktit dhe lëshimin e certifikatës së origjinës.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar specialistët e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave dhe Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore) si dhe është koordinuar me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve.

Projektvendimi, do të dërgohet për mendim në ministrinë e linjës, nëpërmjet sistemit *e-aktet*, konkretisht në Ministrinë e Drejtësisë, në Ministrinë e Brendshme, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu, ky projektvendim do përcillet me shkresë zyrtare për mendim edhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, për shqyrtim nga Këshilli Konsultativ.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Relacion për projektvendimin "Për miratimin e procedurave për kryerjen e veprimtarive të shfrytëzimit në fondin pyjor kombëtar nga individë apo subjekte të licensuara"

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shitesë për buxhetin e shtetit, por parashikohet të çojë në rritje të të ardhurave për buxhetin e njësisve të vetëqeverisjes vendore.

PROPOZUES

MINISTËR

Mirela KUMBARO FURXHI